

UDHËZIM
Nr. 14/2, datë 8.10.2015

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 24, DATË 2.9.2008,
“PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 49.4 shfuqizohet.
 2. Pika 50.10 shfuqizohet.
 3. Format 1, “Njoftim për mospranimin e kërkesës për rimbursim të TVSH-së”, formati 2, “Njoftim për pranimin e kërkesës për rimbursim të TVSH-së” dhe formati 3, “Njoftim për miratimin e rimbursimit të TVSH-së”, që i bashkëlidhen udhëzimit, zëvendësohen nga formati 1, formati 2 dhe formati 3, me të njëjtin emërtim, që i bashkëlidhen këtij udhëzimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
 4. Pas formatit nr. 3, “Njoftim për miratimin e rimbursimit të TVSH-së”, shtohen formati 4, “Urdhërpagesa për thesarin” dhe formati 5, “Njoftim për refuzimin e kërkesës për rimbursim të TVSH-së”, që i bashkëlidhen këtij udhëzimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
- Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE
Shkëlqim Cani